



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

P.nr.02/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, në çështjen penale kundër të pandehurve: I. Sh. nga fshati Topanicë, Komuna e Kamenicës të cilin e mbron av. Milot Spahiu nga Gjilani dhe R. V. nga Gjilani, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.2179/2022, të datës 05.01.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe shpalljes me datë datës 16.06.2023, me datë datë 11.07.2023, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I. I pandehuri I. Sh., nga babai I. dhe nëna S., e lindur M., i lindur më datë 19.12.1994, në Gjilan, me vendbanim në Prishtinë në rr.“Muharrem Fejza”,(ndërtesat e Pozhegut), hyrja C-11,banesa nr.3, ka të kryer shkollën e mesme, student i vitit të IV, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa dënuar me parë, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. I pandehuri R. V., nga babai N. dhe nëna Luljete, e lindur Sh., i lindur më datë 29.01.1997, në Gjilan, ku edhe jeton në lagjen Dheu i Bardh, rr.”Qamil Bala”,nr.5/8, ka të kryer shkollën e mesme, student i vitit të III, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse më datë 26.Nëndor 2022, rreth orës 12.52 min, në kafiterinë “ Metro”, që ndodhet në rrugën Mulla Idrizi në Gjilan, të pandehurit I. Sh. dhe R. V., në bashkëkryerje dhe me përdorimin e atëqasshëm të dhunës,për shkak të trajtimit të pandërgjegjshëm të fëmiut me autizëm, të përshkruar në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, me dashje i kanë shkaktuar lëndime trupore të pandehurit tani të dëmtuarit I. F., ashtu që fillimisht i pandehuri I. Sh. , prindi i fëmiut FSH i revoltuar nga sjellja e mjekut ndaj fëmiut, hyn në kafiteri dhe i drejtohet të dëmtuarit I. F. , duke e fyer me fjalë të ndryshme ofenduese, e më pas e sulmon duke e goditur me grusht në fytyrë dhe në atë moment ndërhyr edhe i pandehuri R. V., duke e kapur të dëmtuarin për krahu duke e mbajtur nën kontroll, e më pas duke e

tërhequr zvarre për t'a nxjerrë jashtë lokalit, ku gjatë kësaj tërheqjeje i dëmtuari rrëzohet për toke dhe të dy të pandehurit e godasin me grushta dhe shkelma në kokë dhe pjesë të ndryshme të trupit, i dëmtuari prap hyn në lokal dhe futet në pjesën e toaletit, ku pas tij hyjnë edhe të dy të pandehurit dhe vazhdojnë që t'a godasin më grushta, deri sa ndërhyjnë personat prezent dhe i largojnë, kështu që të pandehurit me veprimet e tyre i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit I. F., në formë të ndrydhjeve të indeve të buta të kokës dhe trupit, i cili për shkak të natyrës së lëndimeve është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional të Gjilanit

-Me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Lëndim i lehte trupor, nga neni 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës, të pandehurit :

I GJYKON

Të pandehurit **I. Sh.**, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej **700 €** (shtatqind- euro) të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Të pandehurit **R. V.**, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej **700 €** (shtatqind - euro) të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në afat prej prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Në bazë të nenit 79 të KPP-së, të pandehurve të lartcekur, koha e kaluar në paraburgim nga data 26.11.2022 deri më 19.12.2022, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë si më lartë.

Nëse të pandehurit e lartcekur, nuk dëshirojnë ose nuk mundën ta paguajnë dënimin me gjobë, e ne kuptim të nenit 43 par.3 të KPRK-s, atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'iu llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë

I dëmtuari I. F. nga fsh. Përlepnic, me vendbanim në Prishtinë rr. Elbasani LL II kati II/7, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohen të akuzuarit që secili veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 25 € (njëzetë e pesë- euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë- euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 05.01.2023, ka ngritur aktakuzën me numra PP.II.nr.2179/2022, të datës 19.12.2022, kundër të akuzuarve: I. F. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 254 paragrafi 1 të KPRK-ës, I. F. nga fshati Topanicë, Komuna e Kamenicës dhe R. V. nga Gjilani, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Më datë 14.06.2023, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ish-in prezent prokurorja e shtetit Huma Jetishi, pandehurit I. F., I. Sh. dhe R. V., si dhe avokatët e tyre.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri I. F. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë ndërsa të pandehurit I. Sh. dhe R. V., e kanë pranuar fajsin për veprën penale e cila ju vihet në barrë, prokurorja e shtetit i ka propozuar gjykatës që të vazhdohet me dëgjimin e të pandehurve I. Sh. dhe R. V., ashtu që gjyqtarja e çështjes conform dispozites ligjore neni 35 të KPPK-së, **ka veçuar procedure për të pandehurin I. F.**, duke vazhduar procedurën penale ndaj të pandehurve të lartcekur, për hire të parimit të ekonomizimit të procedurës.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit të pandehurit, I. Sh. dhe R. V., kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë të njëjtit kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë për veprën penale të cilëve ju vihen në barrë sipas aktakuzës lëndore, andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve dhe rrjedhimisht shqyrtimit fillestar ka vazhduar me deklaratimet e palëve lidhur me dënimin.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve për veprën penale për të cilën akuzohen ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve nuk është kundërshtuar as nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, se të akuzuarit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: kallëzimi penal me numër të rastit numër 2022-CA-1647, të datës 26 Nëntor 2022, Raporti fillesatar i incidentit, Deklaratat e të pandehurve I. F., R. V. dhe I. Sh., deklaratat e dëshmitarëve A. R., A. V., A. S., G. R., raporti zyrtar policor Jeton Isufi,

fotografi nga vendi i ngjarjes, kopje certifikata më PL-Lo-99/2000 e datës 18.Shkurt 2020 për dhënien e provimit të licencës, kopje diploma e lëshuar nga Kolegji Heimerer , në emër të A. R. Kopje Diploma me numër 4183 e datës 20.Maj 1998 i lëshuar nga fakullteti I defektologjisë në Beograd në emër të I. F., kopje licenca e punës e datës 18 Shtator 2017 në emër të I. F. e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës një video incizim nga vendi i ngjarjes në kafiterinë ‘Metro’, audio incizimi nga vendi i ngjarjes në ordinancën “AAR Logo Plus “raporti mjekësor me numër të referencës 27280, i datës 26 Nëntor 2022, në emër të të pandehurit I. F. e lëshuar në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan, ekspertiza mjeko ligjore me numër të referencës 06/2022 e datës 16.Dhjetor 2022, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmbajnë asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit I. Sh. dhe R. V., e kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurve duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës, shkallën e përgjegjësisë penale në të cilën përfshihet fakti se të njëjtit kanë qenë plotësisht të përgjegjshëm për veprimet e tyre meqenëse të njëjtit në kohën e kryerjes së veprave penale nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje mendore apo ndonjë sëmundje tjetër, faktin se të njëjtit kanë paraqit një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ta kryer veprën penale për të cilat janë shpallur fajtor si dhe faktin se të njëjtit këto vepra i kanë kryer me dashje dhe atë direkte, po ashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh edhe pranimin e fajsis nga ana e të pandehurve si dhe rrethanat personale të tyre.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurit gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tyre meqenëse të njëjti fajësinë për kryerjen e kësaj vepre e kanë bërë në çdo fazë të procedurës penale, pendimin e tyre të cilin gjykata e mori si pendim real, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurve, faktin se të njëjtit është hera e parë që kanë rënë ndesh me ligjin, premtimin e tyre që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të

pandehurve sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del se të pandehurit këtë veprë penale e kanë kryer me dashje dhe atë direkte sepse të njëjtit e kanë ditur se me veprimet e tyre do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj të njëjtit e kanë dëshiruar përkatësisht kanë ndërmarrë veprime për shkaktimin e pasojës së ndaluar ashtu siç përshkruhet më lartë. Si rrethanë rënduese për të pandehurit gjykata mori edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e tyre për kryerjen e veprës penale siç shihet nga përshkrimi faktik si në dispozitiv të këtij aktgjykimi po ashtu edhe nga provat e çështjes del se të njëjtit kanë qenë të vendosur për të kryer veprën penale e cila ka rezultuar me lëndim të lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurve i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 73 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurve mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar

Duke pasur parasysh se të pandehurit e lartcekur, kanë qëndruar nën masën e paraburgimit nga data **26.11.2022 deri më 19.12.2022**, gjykata në kuptim të nenit 79 të KPRK-ës, kohën e kaluar në paraburgim, të njëjtëve do ja llogaritë në dënimin e shqiptuar me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike Gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 për realizmin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e lartcekur i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve, gjykata duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurit ti detyrojë që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 25 € (njëzetë e pesë - euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë-euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr.02/2023, me datë 11.07.2023

Gjyqtarja e vetme gjyqësore
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.